



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Rr. Sheshi i Lirisë, p.n. Fushë Kosovë 12000, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KMDK.SH.A	
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD	
Nr.	01-46/07
Dt.	03/03/2025
Fushë Kosovë	
Shtojce	

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A

Nr. 07/2025

Datë: 28.02.2025

Bazuar në Ligjin Për Ndërmarrje Publike 03/L-087 neni 21, neni 14, neni 18 paragrafi 18.2, neni 31 paragrafi "b", neni 35, Ligjin për Shoqëritë Tregtare 06/L -016 neni 162, Statuti i KMDK Sh.A neni 14, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/214 të datës 24.07.2024 për emërimin e BD të KMDK Sh.A, Kodi i Etikës për Qeverisje Korporative të NP "1.2 Zbatimi i këtij Kodi" dhe "3.4 Shënimet e pasakta dhe çorientuese", Bordi i Drejtorëve i KMDK Sh.A në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. I ndërpritet kontrata e punës me KMDK Sh.A z.Shpend Gjugja i emëruar në pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit" me vendimin e BD të KMDK Sh.A nr 23/2023 nr të protokolit 01-33/23 i datës 02.10.2023.
- II. Shfuqizohet vendimi i Bordit të Drejtorëve nr.23/2023, i datës 02.10.2023, nr të protokolit 01-33/23 për emërimin e Shpend Gjugja në pozitën "Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit".
- III. z.Shpend Gjugja obligohet ti kthejë asetet e KMDK-së që i ka në shfrytëzim.
- IV. KMDK Sh.A obligohet të kompenzojë Shpend Gjugja për pagën e muajit mars 2025, ditët e pushimit vjetor të pashfrytëzuara dhe ato të akumuluar gjatë 2025.
- V. KMDK detyrohet të zbatojë këtë vendim.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KMDK Sh.A.

Arsyetim

Bazuar në kompetencat ligjore dhe detyrat mbikëqyrëse dhe fiduciare, Bordi i Drejtorëve i KMDK SH.A është detyruar të ndërmerri masat ligjore kundër Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit të KMDK Sh.A për shkak të përmbushjes së detyrave në mënyrë të pakënaqshme.

Gjithashtu, bazuar në faktin që zyrtarët e lartë për punën ditore i raportojnë Kryeshefit Ekzekutiv (KE), i cili në vazhdimësi ka paraqitur vërejtjet e tij te BD për dështimin e ZKFTH në përmbushjen e detyrave nga ZKFTH. Shpend Gjugja, në pozitën e ZKFTH, përgjatë dy viteve ka dështuar të hartojë Planin e Biznesit cilësor, dhe kjo barrë i mbeti KE. z. Gjugja ka dështuar ta kryesojë komisionin disiplinor (KD) të cilin e mori përsipër vullnetarisht ta kryesojë, dhe duke bërë dëm me zvarritjen e procedurës, ka bërë gjënë më të papranueshme sepse përveç që si kryesues i KD nuk doli me ndonjë vendim me shkrim sikurse kërkohet me neni 10 të Rregullores së Brendshme Disiplinore 03/2017 për Kodin e Mirësjelljes dhe Procedurat Disiplinor, z.Gjugja jozyrtarisht ka

komunikuar me zyrtarët që ishin objekt i fletëparaqitjes së KE (të paraqitur në janar 2024) dhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit Disiplinor është deklaruar jashtë seancës dhe privatisht se “ju jeni të pafajshëm”. Duke e zvarritur procedurën qëllimisht dhe me vetëdije të plotë, nuk ka nxjerrë vendim të shkruar të çfarëdo lloji (qoftë në favor të punonjësve) dhe kjo përbën shkelje të Rregullores së Brendshme Disiplinore 03/2017 për Kodin e Mirësjelljes dhe Procedurat Disiplinor neni 10 ku shprehimisht kërkohet që Komisioni Disiplinor të nxjerr vendim. **Mos nxjerrja e vendimit pas zhvillimit të procedurës, dëgjimit të palëve, përbën shkelje të Ligjit 05/L -031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative neni 97 paragrafi 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative. dhe Neni 98 “1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.” dhe paragrafi 2 i nenit 98 “2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.”** Për më tepër z.Gjugja si kryetar i komisioni disiplinor nuk ka bërë asnjë kërkesë për shtyerje të afatit por qëllimisht ka zvarritur procedurën e nxjerrjes së vendimit për të komprometuar gjithë procesin disiplinor, dhe duke komunikuar privatisht dhe jozyrtarisht jashtë seancave të Komisionit Disiplinor, veprimi në dëm të komisionit disiplinor, dhe duke shkelur parimet procedurale dhe duke shpërndarë thashetheme me qëllim për të cenuar rëndë integritetin e KE dhe zyrtarëve tjerë të lartë, bëri shkelje të nenit 8 të Rregullores së Brendshme Disiplinore 03/2017 për Kodin e Mirësjelljes dhe Procedurat Disiplinor paragrafi **“k) Mbajtja e qëndrimit të vazhdueshëm destruktiv apo përcarës në vendin e punës.”** dhe **pika m) Neglizhenca dhe sjellja jo e duhur që shpion në dëm të ndërmarrjes”**. Me veprime të tilla ka dëmtuar dhe degraduar kredibilitetin e komisionit disiplinor të ndërmarrjes si organ i brendshëm i pavarur. Këto përbëjnë dhe shkelje të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative të NP ku specifikisht kërkohet që **“çdo i punësuar ka përgjegjësi t’i bindet ligjit dhe të veprojë në mënyrë të ndershme dhe etike”**, ndërsa në rastin e z Gjugja nuk është respektuar ky Kod dhe ka shkelur paragrafin 1.2 i cili thekson **“Ky Kod zbatohet nga të gjithë të punësuarit, zyrtarët dhe drejtorët e Ndërmarrjes. Secili person që i thyen këto politika i nënshtrohet veprimeve disiplinore, që mund të shpërfaqen deri në përfundimin e kontratës së punësimit dhe ndërprerjen e të gjitha bashkëpunimeve.”**

ZKFTTh ka dështuar në vazhdimësi të sjellë raporte financiare në të cilat menaxhmenti do të mund të bazohet. Në çdo lloj raportimi ka dështuar të përmbushë detyrën e vet, me vonesa, e deri në ikje të afateve. Shkaku i dështimit të ZKFTTh t’i përcjellë dhe kryej me kohë pagesat ndaj furnitorëve, KMDK-së disa herë i janë shkëputur Deponitë nga rrjeti elektrik për shkak të mos shlyerjes së borxhit të rrymës, me ç’rast janë shkaktuar probleme operative në matjen e saktë dhe regjistrimin e sasive të mbeturinave në bazë të të cilave regjistrime bëhet edhe faturimi për klientët e KMDK. ZKFTTh, poashtu dështoi t’i adresojë gjetjet nga auditori i jashtëm edhe pse ishte kërkesë e vazhdueshme e KE të hartohet një plan për adresimin dhe zbatimin e rekomandimeve për gjetjet e Auditorit. ZKFTTh, dështoi në adresimin e shkeljeve nga një zyrtarë i drejtorisë së tij i cili në vazhdimësi keqpërdor pushimet mjekësore, dhe duke mos i ndjekur procedurat disiplinore sipas këshillave të KE dhe mëpas zyrtares ligjore, e ka lënë barrë për KE. Në tre muajt e fundit kanë filluar sjellje jokolegiale ndaj kolegëve të cilët i ka vu nën presion e të cilët janë ankuar të KE verbalisht por edhe përmes emailit, e të gjitha përbëjnë shkelje të Rregullores Disiplinore të KMDK dhe Kodit të Etikës. Rrjedhimisht KE i ka propozuar BD ndërprerjen e kontratës së punës për ZKFTTh, meqë pas të gjitha mundësive dhe mbështjetjes në të gjitha aspektet nga KE, ZKFTTh nuk ka arritur të reflektojë dhe ngris kapacitetin profesional, dhe të ruaj parimet bazë të etikës.

Nga Komisioni i Auditimit dhe Bordi i Drejtorëve i KMDK në vazhdimësi i është tërhequr vërejtja z.Shpend Gjugja ZKFTTh për raporte të pasakta, kontradiktore në shifra dhe narrativë, ku pjesa

Komisioni i Auditimit i KMDK të kërkojë rekrutimin e stafit shtesë për ti ndihmuar në zbatimin e detyrave të tij por z.Gjugja e ka refuzuar një mundësi të tillë. Kërkesat e vazhdueshme të Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve për përmisimin e raportimeve financiare, dhe këshillat e ofruara nga anëtarët e KA dhe BD, janë shpërfillur në vazhdimësi derisa BD i KMDK Sh.A në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025 qe detyruar të refuzojë edhe miratimin në parim të raporteve mujore nëntor dhe dhjetor 2024 për shkak të pasaktësive dhe pakënaqësive të shumta. Filluar nga formati i raportimit i cili është kërkuar në vazhdimësi të ndryshohet sepse nuk i plotësonte kërkesat për analizën financiare të ndërmarrjes rrjeshimisht ishte i padobishem për BD, në raportet financiare vërehej mos-harmonizimi i tabelave dhe shifrave, diskrepancë në mes të shifrave të raporteve mujore dhe shifrave të përfshira për muajt e njëjtë në raportet tremujore, dhe e gjithë kjo krijoi një situatë ku BD nuk kishte më besim dhe siguri në raportimin financiar të KMDK, me ç'rast i vështirësohej dhe vendim-marrja. Këto përbëjnë dhe shkelje të Kodit të Etikës, pika 3.4 **“Shënime të pasakta dhe çorientuese 3.4 Asnjë punëtor nuk duhet që me qëllim të bëjë shënime, dosje ose llogari të pasakta, në librat dhe dosjet e Ndërmarrjes. Kjo nuk aplikohet vetëm për dosjet e kontabilitetit, por në mënyrë të barabartë aplikohet për të gjitha llojet e dosjeve, duke përfshirë, p.sh. dosjet për proceset operative, administrative dhe të personelit. Thyerja e këtyre rregullave duhet të përfundojë me ndërprerjen e kontratës së të punësuarit, e ndoshta, edhe me veprimet e mëtutjeshme ligjore.”**

KMDK është në fazën investive në zbatimin e Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II-IV në Kosovë, investim i KfW, BE dhe Qeverisë së Kosovës, dhe ka nevojë për një ZKFTTh me nivel adekuat profesional që t'i përmbushë kërkesat e aspektit financiar lidhur me menaxhimin e programit 70milionësh.

Konkluzion

Sipas legjislacionit pozitiv përkatës, Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e vazhdueshme të veprimtarisë së zyrtarëve të lartë të NP. Për shkak të ngecjes së punëve në drejtorinë e financave në KMDK Sh.A të udhëhequr nga ZKFTTh, është parë e arsyeshme që BD i KMDK Sh.A të merr vendimin si në dispozitivin e këtij vendimi. Dëshmi janë të gjitha materialet e dërguara për mbledhjet e KA dhe BD si dhe procesverbalet e mbledhjeve të KA dhe BD.

Këshilla Juridike

Nga dita e pranimit të këtij vendimi, pala e pakënaqur gëzon të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në afat prej tridhjetë (30) ditësh në Gjykatën Themelore në Prishtinë.



Vendimi i dërgohet;

- Anëtarëve të BPD-së,
- Arkivit të KMDK-së
- NJPMNP/ME
- Drejtorisë së Administratës KMDK Sh.A
- Drejtorisë së financave të KMDK Sh.A
- Z. Shpend Gjugja